

PROFLET E BIZNESEVE: Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë



Profilat e bizneseve:
Ndërmarrësia e grave dhe
pakicave etnike në Kosovë

Gusht 2023

Deklaratë mohimi:

"Ky raport u mundësua me mbështetjen e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e raportit mbetet përgjegjësi vetëm e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara."

Ky raport është shkruar fillimisht në gjuhën angleze.

— Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	4
1. Konteksti	5
1.1. Metodologjia	6
1.2. Të dhënat e ndara sipas gjinisë	7
2. Trendet e bizneseve aktive në Kosovë	7
2.1. Vështrime mbi bizneset aktive në pronësi të grave	10
2.2. Vështrime mbi bizneset në pronësi të pakicave	13
3. Jetëgjatësia e bizneseve në pronësi të grave	17
4. Përfundimi dhe Rekomandimet	20
Aneksat	21

Lista e Shkurtesave

OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
GAP	Instituti GAP
AZhGjE	Aktiviteti Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
OZhBE	Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës

Përmbledhja ekzekutive

Numri i bizneseve në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave etnike në Kosovë është rritur viteve të fundit. Megjithatë, këto biznese mbeten të nënpërfaqësuar në skenën e ndërmarrësisë në Kosovë. Kështu, ky raport ofron të dhëna të përditësuara të bizneseve në pronësi të grave dhe të pakicave, duke përfshirë madhësinë e këtyre bizneseve, aktivitetin e tyre primar ekonomik dhe rajonin e operimit. Për më tepër, raporti ofron të dhëna për jetëgjatësinë e bizneseve në pronësi të grave. Për të krijuar një pasqyrë të profileve të këtyre bizneseve në krahasim me shumicën e bizneseve të cilat janë në pronësi të burrave, kemi analizuar 96,995 biznese¹ nga 227,759 sosh sa janë regjistruar nga viti 2000 deri në mars të 2023². Gjetjet e kësaj analize tregojnë se bizneset në pronësi të grave janë të përqendruara në tregtinë me shumicë dhe pakicë (27%), aktivitete të shërbimeve (17.1%), dhe prodhimtari (12.4%), ndërsa sektorë të tillë si miniera dhe gurore (0.1%), furnizimi me ujë, kanalizimet, aktivitetet e menaxhimit dhe riparimit të mbetjeve (0.1%), aktivitetet e familjeve si punëdhënës, prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara (0.006%) dhe aktivitetet e organizatave dhe organeve jashtëterritoriale (0.006%) kanë pjesën më të vogël të bizneseve në pronësi të grave. Ndërsa, bizneset në pronësi të pakicave janë të fokusuara në tregtinë me shumicë dhe pakicë, riparimin e automjeteve dhe motoçikletave (27.7%), prodhimtari (13.7%) dhe bujqësi, pylltari dhe peshkim (10.4%), dhe janë kryesisht të vendosura në Prishtinë, Prizren dhe Graçanicë.

Statistikat kryesore:

- Sipas të dhënave të ARBK-së, ekzistojnë 96,995 biznese aktive (me përjashtim të ndërmarrjeve publike) që nga marsi 2023. Prej tyre, 78.7% janë në pronësi të burrave, 18% janë në pronësi të grave, 2.3% janë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje, ndërsa për 1% të tjera gjinia e pronarit/es nuk dihet³.
- Bizneset mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë 99% të numrit të përgjithshëm të bizneseve në pronësi të grave në Kosovë.
- 97.7% e bizneseve në pronësi të grave janë biznese mikro me nëntë ose më pak punonjës, 1.5% janë biznese të vogla me 10 deri në 49 punonjës dhe 0.2% janë biznese me 50 deri në 249 punonjës. Aktualisht nuk ka biznese të mëdha me më shumë se 250 punonjës në pronësi të grave.
- Komunitet që kanë boshllëkun më të madh të pabarazisë gjinore sa i përket bizneseve në pronësi të burrave dhe grave janë Dragashi (90.1% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe vetëm 9.5% në pronësi të grave), Malisheva (85.5% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe vetëm 13.5% në pronësi të grave), dhe Rahoveci (85% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe vetëm 13.5 në pronësi të grave). Në anën tjetër, komuna me ndarjen gjinore më të barabartë është ajo e Parteshit (52.6% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe 47.4% në pronësi të grave). Aktiviteti primar më i zakonshëm në mesin e bizneseve në pronësi të grave është tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani; pastaj nga tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara dhe aktivitete shërbimesh.
- 5,253 biznese⁴ janë në pronësi të individëve të pakicave etnike në Kosovë; 30% të serbëve, 28% të turqve, 10.5% të boshnjakëve, 2.7% të goranëve, 2% të ashkalive, 1.7% të romëve, 1.7% të egjiptianëve, 0.1% të malazezëve, kurse 22% prej tyre nuk janë të kategorizuara.
- Nga numri i përgjithshëm i bizneseve në pronësi të pakicave etnike, 79% janë në pronësi të burrave dhe 21% në pronësi të grave.
- Ekzistojnë 33,003 biznese të çregjistruara në Kosovë nga viti 2000 deri në mars 2023, në krahasim me 227,759 e bizneseve të regjistruara gjithsej. Prej tyre, 64% janë në pronësi të

1 Nxjerrur nga ARBK përmes kërkesës për qasje në të dhënat mbi numrin total të bizneseve aktive në Kosovë.

2 ARBK, [Raporti mbi shënjeshtën e performancës themelore mbi regjistrimin e bizneseve në Kosovë për periudhën: Janar-Mars 2023](#).

3 Në ato rase ku nuk dihet gjinia, ka të ngjarë që aplikuesi nuk e ka veçuar gjininë ose ARBK-ja nuk e ka regjistruar atë, ose pronar është ndonjë shoqëri tjetër tregatë (entitet ligjor). Prandaj edhe nuk është dhënë gjinia.

4 Janë përfshirë të gjitha llojet e bizneseve të përshkruara në Aneksin 1.

burrave, 12% në pronësi të grave, 0.3% në pronësi nga të paktën një grua, dhe për 23,7% të bizneseve nuk dihet gjinia e pronarëve/eve.

- Analiza e 3,801 bizneseve të regjistruara në pronësi të grave tregon se jetëgjatësia mesatare për bizneset në pronësi të grave është 4.36 vjet, që është më e vogël se jetëgjatësia mesatare prej 8.1 vjetësh për bizneset në pronësi të burrave.
- Bizneset me jetëgjatësinë më të shkurtër, në pronësi të grave, operojnë në këta sektorë: administratë publike dhe mbrojtje, sigurim shendetësor të detyrueshëm (2 vite); bujqësi, pylltari dhe peshkim (2.32 vite); dhe aktivitete të pasurive të paluajtshme (2.33). Bizneset me jetëgjatësinë më të madhe, në pronësi të grave, operojnë në këta sektorë: tregti me shumicë dhe pakicë (6.71 vite), dhe transportim dhe magazinim (6.53 vite).

Të kuptuarit e natyrës dhe profileve të ndërmarrjeve në pronësi të grave dhe të pakicave mund të ndihmojë qeverinë dhe palët e tjera të interesuara të hartojnë dhe zbatojnë politika dhe programe që mbështesin në mënyrë adekuate këto kategori. Konkretisht, të dhëna të tilla mund të informojnë autoritetet vendimmarrëse, donatorët, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara për kapacitetet absorbuese të bizneseve, për hartimin e duhur të programeve të trajnimit dhe mentorimit, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në mundësitë e prokurimit, etj.

1. Konteksti

Sipërmarrja njihet si një faktor vendimtar për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Duke krijuar mundësi punësimi, sipërmarrësit dhe punonjësit e tyre jo vetëm që përfitojnë vetë, por gjithashtu ndikojnë pozitivisht te investitorët, furnizuesit dhe komunitetet e tyre. Megjithatë, gratë sipërmarrëse janë ende të nënpërfaqësuar, ku ka më pak gra se burra që fillojnë biznese. Bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave etnike priren të jenë më të pakta dhe të kenë më shumë gjasa të operojnë në sektorë më pak fitimprurës. Shumë prej tyre operojnë në ekonominë joformale, për shkak të barrierave të tilla si qasja e kufizuar në kredi, qasja në informacione, tregje dhe teknologji, së bashku me përgjegjësitë familjare dhe normat shoqërore⁵. Megjithatë, sektori privat luan një rol vendimtar në promovimin e krijimit të vendeve të punës dhe rritjen e standardeve të jetesës, duke e bërë thelbësore përfshirjen aktive të grave në aktivitetet ekonomike⁶. Inkurajimi i sipërmarrjes gjithëpërfshirëse mund t'i mundësojë ekonomitë të shfrytëzojnë potencialin dhe idetë e grave dhe individëve nga pakicat etnike në tregun e punës⁷.

Numri në rritje i grave sipërmarrëse priret të ndikojë pozitivisht në mundësitë e punësimi të grave dhe minoriteteve. Raporte të ndryshme tregojnë se bizneset në pronësi të grave priren të punësojnë më shumë gra dhe punonjës të pakicave⁸, dhe të kryejnë biznes me shitës dhe furnitorë në pronësi të grave⁹.

Papunësia e lartë zyrtare në Kosovë, e vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si 20.7% në vitin 2021¹⁰. Sipas ASK-së, papunësia te gratë ishte më e lartë me 25% në vitin 2021, krahasuar me burrat me 19%. Në Kosovë ekziston një ekonomi e madhe joformale e cila mund të mos përfshihet gjithmonë në të dhënat zyrtare, veçanërisht në sektorin e bujqësisë. Nga gratë e punësuar, 4,9% e tyre kishin statusin e punësimi "e vetëpunësuar", krahasuar me 10,8% të burrave të punësuar¹¹. Gratë janë kryesisht të punësuar në sektorët e arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë me 51,8%, ndërsa burrat janë të punësuar kryesisht në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit me 41,8%¹².

5 Rrjeti i Grave të Kosovës. [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Ballkanin Perëndimor, 2022.](#)

6 Grupi i Bankës Botërore. [Gratë, Biznesi dhe Ligji 2023](#), Instituti Riinvest. [Ndërmarrësia e grave: Një analizë mbi të bërit biznes në Kosovë, 2017.](#)

7 Po aty.

8 McManus, Michael J. [Gratë në pronësi të bizneseve: Të dhënat e Anketës së vitit 2012 mbi pronarët/et e bizneseve, 2017.](#)

9 [Gjendja e bizneseve në pronësi të grave, 2019](#), American Express.

10 Agjencia e Statistikave të Kosovës. [Anketa e Fuqisë Punëtore \(AFP\) në Kosovë, 2021.](#)

11 Agjencia e Statistikave të Kosovës. [Statistikat Sociale – treguesit e arsimit dhe tregut të punës sipas gjinisë, 2023.](#)

12 Po aty.

Një studim i kryer nga Global Entrepreneurship Monitor, zbulon se gratë sipërmarrëse kanë më shumë gjasa të fillojnë biznese në sektorin e shërbimeve, si kujdesi shëndetësor, arsimi dhe mikpritja. Këto biznese priren të jenë më të vogla në madhësi dhe shpesh operojnë në sektorin joformal. Studimi zbuloi gjithashtu se bizneset në pronësi të grave priren të kenë më pak punonjës dhe të gjenerojnë të ardhura më të ulëta në krahasim me ato në pronësi të burrave¹³. Gjetje të ngjashme vlejnë edhe për Kosovën. Sipas një raporti të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, gratë ndërmarrëse në Kosovë janë të përqendruara kryesisht në sektorin e shërbimeve, duke përfshirë kujdesin shëndetësor, arsimin dhe shitjen me pakicë. Ato janë gjithashtu aktive në industrinë kreative si në modë, dizajn dhe artizanate. Shumë gra ndërmarrëse në Kosovë operojnë me biznese të vogla dhe mikro, por ka edhe disa që kanë krijuar kompani më të mëdha dhe po zgjerohen në tregjet ndërkombëtare¹⁴. Përkundër një sektori financiar të themeluar mirë në Kosovë, që dominohet nga sektori bankar, qasja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në kredi bankare është e kufizuar nga normat e larta të interesit, kërkesat e larta për kolateral dhe mosgatishmëria relative e bankave për të financuar projekte të reja nga sipërmarrjet e vogla dhe të vogla dhe sipërmarrjet fillestare "start-ups"¹⁵.

Bizneset në pronësi të grave dhe të pakicave mund të luajnë poashtu një rol të rëndësishëm në promovimin e rritjes dhe zhvillimit ekonomik, si dhe të kontribuojnë në diversitetin social dhe kulturor të Kosovës. Duke mbështetur dhe promovuar rritjen e këtyre bizneseve, Kosova mund të krijojë mundësi ekonomike më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët e saj.

1.1. Metodologjia

Instituti GAP, për këtë raport ka përdorur burime të të dhënave parësore dhe dytësore. GAP ka pranuar të dhëna nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për bizneset në pronësi të grave, për sektorin ekonomik në të cilin operojnë ato, rajonin ku operojnë dhe për madhësinë e këtyre bizneseve. Gjithashtu, të dhëna janë marrë edhe nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); megjithatë, kjo e fundit nuk posedonte të dhëna të plota të ndara sipas gjinisë dhe apo përkatësisë etnike. Këto të dhëna u morën për të bërë një krahasim dhe për të siguruar saktësinë e të dhënave. Meqë të dhënat e ATK-së nuk paraqitnin ndarjen e bizneseve në bazë të gjinisë dhe etnisë, GAP ka përfshirë vetëm të dhënat nga ARBK-së për këtë analizë. Nga numri gjithsej i bizneseve të regjistruara nga viti 2000 deri në marsin e 2023, pra 227,759 gjithsej, është zbritur numri i bizneseve që nuk kanë të dhëna të përditësuara. Pas zbritjes, numri i bizneseve aktive sipas ARBK mbetet 96,995. Megjithatë, është e rëndësishme të thuhet se këto shifra nuk përputhen me të dhënat tjera të disponueshme, si ato të ATK, e cila i ka dhënë GAP-it një listë prej 115,381 biznesesh aktive të regjistruara nga viti 2000 deri në marsin e vitit 2023¹⁶. Poashtu, i njëjti raport nga ASK-ja jep dy shifra të ndryshme biznesesh aktive në Kosovë. Sipas këtij raporti, ekzistojnë 74,658 biznese aktive në Kosovë në vitin 2021, shifër kjo e nxjerrur nga të dhënat e ATK¹⁷. Të dhënat nga OZhBE (42,881 në vitin 2020) poashtu dallojnë nga shifrat e lartpërmendura. Kjo shpërputhje e të dhënave shpie në gabime në kalkulime dhe nënvlerësim apo mbivlerësim të të dhënave meqë numri i saktë i popullësisë totale për bizneset aktive mbetet i panjohur.

Sa i përket bizneseve në pronësi të pakicave, ishte akoma më e vështirë për të marrë ndonjë të dhënë pasi që nuk kishte informacion të qasshëm online, megjithatë GAP i mori disa nga këto të dhëna nga MINT.

13 Monitori Global i Ndërmarrësisë. [Ndërmarrësia e Grave 2018/2019](#).

14 OECD. [Konkurrueshmëria në Evropën Juglindore 2021: Profili i Kosovës](#).

15 Banka Botërore. [Programi për Vlerësimin e Sektorit Financiar të Kosovës: Faza 1 dhe Faza 2](#). Grupi i Bankës Botërore, 2018.

16 GAP-i i ka siguruar këto të dhëna nga ATK-ja përmes një kërkesë për çasje në të dhëna.

17 ASK. [Vjetari i statistikave i Republikës së Kosovës, 2022](#).

GAP ka përpunuar këto grupe të dhënash (ku mungonte ndarja e plotë sipas gjinisë) dhe ka krijuar një pasqyrë se ku fokusohen më shumë bizneset në pronësi të grave dhe pakicave, si dhe jetëgjatësinë e këtyre bizneseve. Kjo është bërë duke i kategorizuar të gjitha hyrjet e të dhënave në tri kategori "në pronësi të grave", "në bashkëpronësi të grave" dhe "në pronësi të burrave" në mënyrë që të sigurohet një krahasim. Meqenëse jo të gjitha shënimet e të dhënave ishin të ndara sipas gjinisë, GAP kërkoi më shumë se 3,000 hyrje individualisht në platformën online të ARBK-së për të identifikuar gjininë e pronarëve/eve. Për më tepër, GAP është mbështetur në raportet zyrtare të qeverisë ku ka bërë rishikimin e literaturës dhe të dhënat e disponueshme online lidhur me zhvillimet më të fundit në sipërmarrjen e grave dhe minoriteteve në Kosovë.

1.2. Të dhënat e ndara sipas gjinisë

Institucionet e Kosovës nuk mbledhin dhe nuk mbajnë në mënyrë sistematike të dhëna të ndara sipas gjinisë për të informuar mbi politikat fiskale dhe shpërndarjen e burimeve. Edhe e kur bëjnë këtë, shifrat shpeshherë nuk janë të njësuara dhe ekziston një shpërputhje në të dhëna. Këtu përfshihet edhe Administrata Tatimore e Kosovës. GAP-i ka përdorur të dhënat e ATK-ës me qëllim që t'i krahasojë me ato të ARBK-ës për të krijuar një pasqyrë më të besueshme të ambientit biznesor në Kosovë për gratë dhe minoritetet. ATK-ja ka një bazë të dhënash më të përditësuar meqë të gjitha bizneset janë të detyruara t'i deklarojnë fitimet e tyre vjetore (edhe kur fitimi del 0). Megjithatë, ATK-ja nuk ka të dhëna të plota mbi ndarjen e bizneseve sipas gjinisë, gjë që ka penguar procesin e hulumtimit. Edhe pse Ligji për barazi gjinore obligon çdo institucion në Kosovë që të zbatojë masa legjislative dhe masa të tjera me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor dhe arritjes së barazisë gjinore, (përfshirë "ndarjen gjinore të të gjitha të dhënave dhe informacioni statistikor që mblidhet duhet të regjistrohet, të përpunohet dhe të dorëzohet detyrimisht në Agjencinë e Statistikave të Kosovës"¹⁸) ka pak të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me sektorin e biznesit në Kosovë. Ky ligj parasheh edhe sanksione ndëshkimore për shkeljen e nenit 5: "Një gjobë prej 300 deri në 500 euro do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës sipas nenit 5 nënparagrafi 1.8 i këtij ligji, nëse nuk mblidhen, regjistrohen dhe përpunohen të dhënat statistikore të ndara sipas gjinisë dhe të mos dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës"¹⁹.

Ndërsa kur bëhet fjalë për grupe të pakicave etnike, shtohet pesha e ndërthurrjes.²⁰ Nuk ka të dhëna zyrtare të punësimit për individët e grupeve pakicë. Përderisa nuk ka të dhëna publike për këto biznese, GAP ka arritur të marrë të dhëna të ndara sipas gjinisë për bizneset në pronësi të individëve të grupeve të pakicave etnike përmes kërkesave për të dhëna.

2. Trendet e bizneseve aktive në Kosovë

Sipas ARBK-së, 96,995 biznese aktive janë të regjistruara në periudhën 2000 deri në mars 2023. Prej tyre, 53,146 (54,8%) janë biznese individuale, 42,513 (43,8%) janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.P.K), 576 (0.59%) janë ortakëri të përgjithshme, 465 (0.46%) janë degë të shoqërive të huaja, 231 (0.24%) janë shoqëri aksionare (SH.A.), 49 (0.05%) kooperativa bujqësore, 11 (0.01%) ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës, dhe 4 (0.004%) ndërmarrje sociale (llojet e bizneseve janë shpjeguar në Aneksin 1).

¹⁸ [Ligji Nr. 05/L-01 për barazinë gjinore, neni 5, par. 1.8.](#)

¹⁹ Po aty, neni 23, par. 5.

²⁰ Mënyra komplekse, kumulative në të cilën efektet e formave të shumta të diskriminimit (si racizmi, seksizmi dhe klasizmi) kombinohen, mbivendosen ose kryqëzohen veçanërisht në përvojat e individëve ose grupeve të marginalizuara.

Tabela 1. Llojet e bizneseve, sipas gjinisë së pronarëve/eve dhe bashkëpronësisë


Burimi: ARBK

	Në pronësi të burrave		Në pronësi të grave		Në bashkëpronësi të grave		NA		Gjithsej
Bizneset individuale	42,204	79.4%	10,942	20.6%	0		0		53,146
Degët e shoqërive të huaja	126	27%	0		0		339	73%	465
Kooperativat bujqësore	22	45%	5	10%	22	45%	0		49
Ndërmarrjet sociale	4	100%	0		0		0		4
Ndërmarrjet tjera nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit	5	100%	0		0		0		5
Shoqëritë komandite	4	66.66%	0		0		1		6
Ortakëritë e përgjithshme	422	73.3%	20	3.5%	129	22.4%	5	0.9%	576
Shoqëritë aksionare	174	75.3%	8	3.5%	21	9.1%	28	12%	231
Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara	33,364	78.5%	6,440	15.1%	2,111	5%	598	1.4%	42,513
Gjithsej	76,325	78.7%	17,415	18%	2,284	2.3%	971	1%	96,995

Të dhënat e marra nga ARBK dhe të kategorizuara sipas gjinisë tregojnë se nga numri i përgjithshëm i bizneseve aktive që veprojnë në Kosovë, 76,325 (78,7%) janë në pronësi të burrave, 17,415 (18%) janë në pronësi të grave, 2,284 (2,3%) janë në bashkëpronësi të së paku një gruaje, dhe për 971 (1%) të ndërmarrjeve nuk dihet gjinia e pronarit.

Figura 1. Numri gjithsej i bizneseve aktive, sipas gjinisë së pronarëve/eve

Burimi: ARBK



Numri më i madh i bizneseve aktive (26.9%) gjendet në Prishtinë, pasuar nga Prizreni (8.7%) (shih Tabelën 2). Komunat me hendekun më të madh të barazisë gjinore sa i përket pronësisë së bizneseve janë Dragashi (90.1% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe 9.5% në pronësi të grave), Malisheva (85.5% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe vetëm 13.5% në pronësi të grave), dhe Rahoveci (85% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe vetëm 13.5% në pronësi të grave). Në anën tjetër, komuna me ndarjen gjinore më të barabartë është ajo e Parteshit (52.6% e bizneseve janë në pronësi të burrave dhe 47.4% në pronësi të grave). Aktiviteti primar më i zakonshëm në mesin e bizneseve në pronësi të grave është tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani; pastaj nga tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara dhe aktivitete shërbimesh.

Tabela 2. Numri i bizneseve aktive, sipas komunës, gjinisë së pronarëve/eve, dhe bashkëpronësisë

	Në pronësi të burrave		Në pronësi të grave		Në bashkëpronësi të grave		NA		Gjithsej
Deçani	773	76.0%	227	22.3%	14	1.4%	3	0.3%	1,017
Dragashi	723	90.1%	76	9.5%	2	0.2%	1	0.1%	802
Ferizaji	6,342	80.2%	1,309	16.6%	136	1.7%	28	0.4%	7,815
Fushë Kosova	2,607	76.8%	655	19.3%	94	2.8%	38	1.1%	3,394
Gjakova	3,424	76.6%	947	21.2%	70	1.6%	30	0.7%	4,471
Gllugoci	1,635	80.3%	361	17.7%	29	1.4%	10	0.5%	2,035
Gjilani	4,552	79.8%	1,025	18.0%	105	1.8%	20	0.4%	5,702
Graçanica	863	75.6%	192	16.8%	51	4.5%	36	3.2%	1,142
Hani i Elezit	261	80.1%	61	18.7%	2	0.6%	2	0.6%	326
Istogu	1,212	79.6%	287	18.9%	20	1.3%	3	0.2%	1,522
Juniku	56	83.6%	10	14.9%	1	1.5%	0	0.0%	67
Kaçaniku	1,042	82.2%	212	16.7%	12	0.9%	2	0.2%	1,268
Kamenica	1,086	80.5%	245	18.2%	14	1.0%	4	0.3%	1,349
Klina	1,187	80.9%	265	18.1%	14	1.0%	1	0.1%	1,467
Klllokoti	45	76.3%	11	18.6%	2	3.4%	1	1.7%	59
Leposaviqi	195	80.6%	43	17.8%	2	0.8%	2	0.8%	242
Lipjani	2,120	83.8%	343	13.6%	51	2.0%	16	0.6%	2,530
Malisheva	1,309	85.5%	206	13.5%	13	0.8%	3	0.2%	1,531
Mamusha	114	70.8%	45	28.0%	2	1.2%	0	0.0%	161
Mitrovica	2,820	79.8%	650	18.4%	45	1.3%	19	0.5%	3,534
Mitrovica e Veriut	252	72.2%	92	26.4%	3	0.9%	2	0.6%	349
Novobërda	137	74.5%	46	25.0%	1	0.5%	0	0.0%	184
Obiliqi	721	81.1%	137	15.4%	22	2.5%	9	1.0%	889
Parteshi	20	52.6%	18	47.4%	0	0.0%	0	0.0%	38
Peja	4,399	77.9%	1,147	20.3%	87	1.5%	17	0.3%	5,650
Podujeva	2,575	83.2%	468	15.1%	44	1.4%	7	0.2%	3,094
Prishtina	19,471	74.5%	4,850	18.6%	1,179	4.5%	629	2.4%	26,129
Prizreni	6,690	79.3%	1,569	18.6%	139	1.6%	42	0.5%	8,440
Rahoveci	1,551	85.0%	246	13.5%	20	1.1%	7	0.4%	1,824
Ranillugu	26	70.3%	10	27.0%	1	2.7%	0	0.0%	37
Shterpca	240	68.8%	98	28.1%	6	1.7%	5	1.4%	349
Shtimja	833	84.3%	147	14.9%	5	0.5%	3	0.3%	988
Skenderaj	1,020	78.1%	267	20.4%	13	1.0%	6	0.5%	1,306
Suhareka	1,978	81.9%	397	16.4%	30	1.2%	11	0.5%	2,416
Vitia	1,576	83.7%	281	14.9%	24	1.3%	3	0.2%	1,884
Vushtrria	2,259	83.3%	414	15.3%	29	1.1%	10	0.4%	2,712
Zubin Potoku	86	81.1%	19	17.9%	1	0.9%	0	0.0%	106
Zveçani	125	75.3%	39	23.5%	1	0.6%	1	0.6%	166
Gjithsej	76,325		17,415		2,284		971		96,995

Burimi: ARBK

Sipas një raporti të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) përfaqësojnë rreth 90% të bizneseve dhe më shumë se 50% të punësit në mbarë botën ²¹. Përveç kësaj, NMVM-të janë përgjegjëse për një pjesë të konsiderueshme të prodhimit ekonomik, që përbën deri në 40% të BPV-së kombëtare në disa vende. Në Kosovë, NMVM-të përfaqësojnë rreth 99% të bizneseve, me vetëm rreth 1% të bizneseve të klasifikuara si biznese të mëdha. Tabela 3 tregon ndarjen e bizneseve sipas gjinisë së pronarëve/eve dhe bashkëpronarëve/eve për çdo madhësi të biznesit. Bizneset mikro janë ato me nëntë apo më pak të punësuar, biznese të vogla janë ato me 10 deri në 49 të punësuar, biznese të mesme janë ato me 50 deri në 249 të punësuar, të mëdha janë bizneset me 250 e më shumë të punësuar dhe të panjohura mbeten bizneset për të cilat nuk dihet numri i të punësuarve sipas të dhënave nga ARBK. Në kolonën e emërtuar të panjohura janë ato biznese për të cilat nuk ka të dhëna mbi gjininë e pronarëve/eve.

Tabela 3. Numri i bizneseve aktive, sipas madhësisë, gjinisë së pronarëve/eve dhe bashkëpronësisë.

	Në pronësi të burrave		Në pronësi të grave		Në bashkëpronësi të grave		Të panjohura		Gjithsej
Mikro	74,219	78.6%	17,232	18.3%	2,105	2.2%	814	0.9%	94,370
Të vogëla	1,418	82.1%	98	5.7%	118	6.8%	94	5.4%	1,728
Të mesme	214	72.5%	8	2.7%	33	11.2%	40	13.6%	295
Të madha	33	66.0%	0	0.0%	6	12.0%	11	22.0%	50
Të panjohura	441	79.9%	77	13.9%	22	4.0%	12	2.2%	552
Gjithsej	76,325		17,415		2,284		971		96,995

Burimi: ARBK

2.1. Vështrime mbi bizneset aktive në pronësi të grave

Sipas të dhënave zyrtare, bizneset në pronësi të grave janë më të përfaqësuara në tregtinë me shumicë dhe pakicë, në aktivitete shërbimi dhe në prodhim. Sektorët me pjesën më të vogël të bizneseve në pronësi të grave janë miniera dhe gurore, aktivitetet e familjeve si punëdhënës; prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara, aktivitetet e organizatave dhe organeve ekstraterritoriale, furnizimi me ujë, kanalizimet, aktivitetet e menaxhimit dhe korigjimit të mbetjeve, si dhe transporti dhe magazinimi. Një trend i ngjashëm vërehet në numrin e bizneseve në bashkëpronësinë e të paktën një gruaje.

²¹ Banka Botërore. [Financat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme \(NVM\)](#).


Tabela 4. Bizneset në pronësi dhe bashkëpronësi të grave, sipas sektorit ekonomik²²

	Në pronësi të grave		Në bashkëpronësi të grave	
	Numri	Përqindja	Numri	Përqindja
A – Bujqësi, pylltari dhe peshkim	1,119	6.5%	86	3.8%
B – Minierat dhe guroret	24	0.1%	12	0.5%
C – Prodhimi	2,164	12.4%	288	12.6%
D – Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	19	0.1%	14	0.6%
E – Furnizimi me ujë, kanalizimet, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit	21	0.1%	15	0.7%
F – Ndërtimi	465	2.7%	135	5.9%
G – Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	4,712	27.0%	530	23.2%
H – Transporti dhe magazinimi	199	1.1%	54	2.4%
I – Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	1,265	7.3%	180	7.9%
J – Informacioni dhe komunikimi	516	3.0%	171	7.5%
K – Aktivitete financiare dhe sigurime	126	0.7%	30	1.3%
L – Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	90	0.5%	41	1.8%
M – Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	1,531	8.8%	325	14.2%
N – Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	656	3.8%	103	4.5%
O – Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	45	0.3%	11	0.5%
P – Arsimi	517	3.0%	62	2.7%
P – Shëndeti i njeriut dhe aktivitetet e punës sociale	720	4.1%	127	5.6%
R – Arte, argëtim dhe rekreacion	236	1.4%	41	1.8%
S – Aktivitete të tjera shërbimi	2,988	17.1%	58	2.5%
T – Veprimtaritë e familjeve si punëdhënës; prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara aktivitetet e familjeve për përdorim vetjak	1	0.0%	0	0.0%
U – Veprimtaritë e organizatave dhe organeve ekstrashterritoriale	0	0.0%	1	0.0%
Të tjera	1	0.0%	0	0.0%
Totali	17,415	100.0%	2,284	100.0%

Burimi: ARBK

Analiza tregon se disa nga aktivitetet primare më të zakonshme të bizneseve në pronësi të grave janë tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani; tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara; tregti të tjera me pakicë, jo në dyqane, tezga apo tregje; restorante dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit; përpunim dhe konservim tjetër i frutave dhe perimeve; sallone flokësh dhe trajtime të tjera bukurie; tregtia me pakicë e artikujve farmaceutikë në dyqane të specializuara; dhe prodhimi i bukës së freskët, simiteve dhe ëmbëlsirave, ndër të tjera.

²² Në llogaritje nuk përfshihen 971 hyrje të të dhënave ku nuk dihet gjinia e pronarëve/eve

Figura 2. Numri i bizneseve aktive në pronësi të grave, sipas komunave

Burimi: ARBK

Prej 17,415 bizneseve në pronësi të grave në Kosovë, 17,232 (98.9%) janë mikro me 9 ose më pak të punësuar/a, 98 (0.6%) janë të vogla me 10 deri në 49 të punësuar/a, 8 (0.05%) janë të mesme me 50 deri në 249 të punësuar/a, dhe asnjë nga bizneset aktive në pronësi të grave nuk janë të mëdha me 250 ose më shumë të punësuar/a.

Tabela 5. Numri i bizneseve aktive në pronësi të grave sipas madhësisë


Madhësia e biznesit	Në pronësi të grave	%
Mikro	17,232	98.9%
Të vogëla	98	0.6%
Të mesme	8	0.0%
Të madha	0	0.0%
Të panjohura	77	0.4%
Gjithsej	17,415	100%

Burimi: ARBK

Figura 3 tregon numrin e bizneseve në pronësi të grave të regjistruara çdo vit nga viti 2000 deri në vitin 2022 që janë aktualisht aktive. Të dhënat për vitin 2023 përfshijnë bizneset në pronësi të grave të regjistruara në janar, shkurt dhe mars 2023 dhe numri pritet të rritet në fund të vitit. Siç është paraqitur, numri i bizneseve në pronësi të grave është rritur në mënyrë progresive në dekadën e fundit. Ky numër është shumëfishuar në periudhën 2018–2019 dhe rritje ka pasur edhe gjatë pandemisë COVID-19 në 2020–2022. Kjo e fundit mund të shpjegohet përmes regjistrimit të bizneseve për të përfituar nga masat ekonomike të Qeverisë së Kosovës si përgjigje ndaj pandemisë ²³.

Figura 3. Numri i bizneseve të reja aktive në pronësi të grave të regjistruara nga viti 2000 deri në mars 2023

Burimi: ARBK



2.2. Vështrime mbi bizneset në pronësi të pakicave

Sipas të dhënave nga ARBK, gjithsej 5,253 biznese në pronësi të individëve të komuniteteve pakicë operojnë në Kosovë. Prej tyre 1,083 (21%) janë në pronësi të grave dhe 4,170 (79%) në pronësi të burrave. Tabela 6 tregon ndarjen e këtyre bizneseve sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë së pronarit/es.

Tabela 6. Numri i bizneseve aktive në pronësi të pakicave, sipas gjinisë

Burimi: ARBK

Etnia	Në pronësi të burrave	Në pronësi të grave	Gjithsej
Serb	1,141 (72%)	440 (28%)	1,581
Turk	1,257 (83%)	251 (17%)	1,508
Boshnjak	408 (73%)	149 (27%)	557
Goran	120 (84%)	23 (16%)	143
Ashkali	84 (80%)	21 (20%)	105
Romët	69 (74%)	24 (16%)	93
Egjiptian	56 (62%)	35 (38%)	91
Malazeze	7 (100%)	0	7
Të tjera	1,028 (88%)	140 (22%)	1,168
Total	4,170 (79%)	1,083 (21%)	5,253

Ngjashëm me trendet e përgjithshme të biznesit në Kosovë, gratë janë të nënprëfaqësuara në mesin e pronarëve të bizneseve të pakicave etnike. Gratë nga pakicat etnike zotërojnë 21% të bizneseve në pronësi të pakicave etnike, ndërsa burrat 79%.

23 EkonomiaOnline. [Hapja e bizneseve të reja në pandemi, një luftë për mbijetesë, 2021.](#)

Figura 4. Numri total i bizneseve aktive në pronësi të pakicave etnike, sipas gjinisë

Burimi: ARBK



Një numër i madh i bizneseve në pronësi të pakicave etnike (27.7%) janë të përqendruara në tregtinë me shumicë dhe pakicë, pasuar nga prodhimi, dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Tabela 7 paraqet të dhëna të ndara sipas gjinisë që tregojnë pjesën e bizneseve në pronësi të grave krahasuar me ato në pronësi të burrave për secilin sektor të ekonomisë.

Tabela 7. Numri i bizneseve aktive në pronësi të pakicave sipas sektorit dhe gjinisë së pronarit/es

Sektori i ekonomisë	Në pronësi të grave		Në pronësi të burrave		Gjithsej	
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	177	32%	370	68%	547	10.4%
B - Minierat dhe guroret	2	7%	25	93%	27	0,5%
C - Prodhimi	160	22%	563	78%	723	13.7%
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	1	2%	54	98%	55	1%
E - Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit	1	3%	35	97%	36	0.6%
F - Ndërtimi	31	8%	335	92%	366	6.9%
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	263	18%	1,194	82%	1,457	27.7%
H - Transporti dhe magazinimi	8	6%	133	94%	141	2.7%
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	88	21%	341	79%	429	8.1%
J - Informacioni dhe komunikimi	46	16%	246	84%	292	5.5%
K - Aktivitete financiare dhe sigurimet	5	11%	40	89%	45	0.8%
L - Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	6	9%	58	91%	64	1.2%
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	76	20%	306	80%	383	7.2%
N - Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	42	22%	148	78%	190	3.6%
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	3	30%	7	70%	10	0.2%
P - Arsimi	11	20%	43	80%	54	1%
P - Shëndeti i njeriut dhe aktivitetet e punës sociale	37	28%	97	72%	134	2.5%
R - Arte, argëtim dhe rekreacion	23	26%	67	74%	90	1.70%
S - Aktivitete të tjera shërbimi	103	49%	108	51%	211	4%
Gjithsej	1,083	21%	4,170	79%	5,253	100%

Burimi: ARBK

Gratë ndërmarrëse të pakicave etnike në Kosovë zotërojnë biznese të cilat kryesisht janë të fokusuar në tregtinë me shumicë dhe pakicë; bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe prodhimi, një tendencë e ngjashme me totalin e bizneseve në pronësi të grave.

Tabela 8. Numri i bizneseve në pronësi të grave nga pakicat etnike, sipas sektorëve të ekonomisë

Burimi: ARBK

Sektori i ekonomisë	Pjesa e bizneseve në pronësi të grave
A – Bujqësi, pylltari dhe peshkim	16.30%
B – Minierat dhe guroret	0,20%
C – Prodhim	14.80%
D – Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	0,10%
E – Furnizimi me ujë, kanalizimet, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit	0,10%
F – Ndërtimi	2.90%
G – Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	24.30%
H – Transporti dhe magazinimi	0,70%
I – Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	8,10%
J – Informacioni dhe komunikimi	4.20%
K – Aktivitete financiare dhe sigurimesh	0,50%
L – Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	0,60%
M – Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	7.00%
N – Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	3,90%
O – Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	0,30%
P – Arsimi	1.00%
P – Shëndeti i njeriut dhe aktivitetet e punës sociale	3.40%
R – Arte, argëtim dhe rekreacion	2.10%
S – Aktivitete të tjera shërbimi	9,50%
Gjithsej	100%

Në Kosovë, 97.9% e bizneseve në pronësi të pakicave etnike janë mikro me nëntë ose më pak të punësuar, 1.8% janë të vogla me 10 deri në 49 të punësuar, 0.2% të mesme me 50 deri në 249 të punësuar dhe vetëm 0.1% klasifikohen si të mëdha, me më shumë se 250 të punësuar.

Tabela 9. Numri i bizneseve në pronësi të pakicave sipas madhësisë së biznesit dhe gjinisë së pronarit

Burimi: ARBK

# i punonjësve	Madhësia	Në pronësi të grave		Në pronësi të burrave		Gjithsej	
0–9	mikro	1,071	21%	4,073	79%	5,144	97.9%
10–49	të vogëla	10	11%	82	89%	92	1.8%
50–249	të mesme	2	18%	9	82%	11	0.2%
250 –	të mëdha	0	0%	6	100%	6	0.1%
Gjithsej		1,083	21%	4,170	79%	5,253	100%

Bizneset në pronësi të grave nga pakicat etnike janë kryesisht biznese mikro me nëntë ose më pak të punësuar, ku vetëm 0.9% janë të vogla dhe 0.2% të mesme me 50 deri në 249 të punësuar. Shumica e bizneseve në pronësi të pakicave etnike janë të vendosura në Prishtinë dhe Prizren.

Tabela 10. Numri i bizneseve në pronësi të pakicave sipas komunës dhe gjinisë së pronarit


Komuna	Në pronësi të grave		Në pronësi të burrave		Gjithsej	
Prishtinë	166	15.3%	1,102	26.4%	1,268	24.1%
Prizren	260	24.0%	941	22.6%	1,201	22.9%
Graçanicë	97	9.0%	277	6.6%	374	7.1%
Mitrovicë Veriore	76	7.0%	203	4.9%	279	5.3%
Leposaviq	37	3.4%	174	4.2%	211	4%
Shtërpcë	59	5.4%	92	2.2%	151	2.9%
Zveçan	35	3.2%	114	2.7%	149	2.8%
Ferizaj	21	1.9%	126	3.0%	147	2.8%
Mamushë	43	4.0%	101	2.4%	144	2.7%
Gjilan	25	2.3%	117	2.8%	142	2.7%
Fushë Kosovë	19	1.8%	94	2.3%	113	2.2%
Dragash	19	1.8%	94	2.3%	113	2.2%
Mitrovicë	12	1.1%	83	2.0%	95	1.8%
Gjakovë	22	2.0%	71	1.7%	93	1.8%
Pejë	13	1.2%	76	1.8%	89	1.7%
Zubin Potok	12	1.1%	62	1.5%	74	1.4%
Lipjan	6	0.6%	58	1.4%	64	1.2%
Istog	19	1.8%	41	1.0%	60	1.1%
Kamenicë	21	1.9%	38	0.9%	59	1.1%
Novobërdë	16	1.5%	41	1.0%	57	1.1%
Obiliq	13	1.2%	30	0.7%	43	0.8%
Vushtrri	10	0.9%	33	0.8%	43	0.8%
Ranillug	16	1.5%	21	0.5%	37	0.7%
Viti	7	0.6%	26	0.6%	33	0.6%
Klinë	17	1.6%	16	0.4%	33	0.6%
Partesh	15	1.4%	14	0.3%	29	0.6%
Podujevë	5	0.5%	21	0.5%	26	0.5%
Suharekë	4	0.4%	17	0.4%	21	0.4%
Klllokot	6	0.6%	12	0.3%	18	0.3%
Kaçanik	1	0.1%	15	0.4%	16	0.3%
Rahovec	3	0.3%	12	0.3%	15	0.3%
Glllogoc	1	0.1%	14	0.3%	15	0.3%
Shtime	2	0.2%	12	0.3%	14	0.3%
Malishevë	2	0.2%	9	0.2%	11	0.2%
Hani i Elezit	0	0.0%	6	0.1%	6	0.1%
Skenderaj	2	0.2%	4	0.1%	6	0.1%
Deçan	1	0.1%	2	0.0%	3	0.1%
Juniku	0	0.0%	1	0.0%	1	0.0%
Total	1,083	20.7%	4,170	79.3%	5,253	100%

Burimi: ARBK

Numri i bizneseve në pronësi të pakicave në Kosovë është rritur në mënyrë progresive përgjatë viteve. Një rritje e ndjeshme prej 117 biznese vërehet në vitin 2013, krahasuar me 2012. Po ashtu 12 biznese janë më shumë në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011. Një rritje tjetër e ndjeshme e numrit të bizneseve në pronësi të pakicave ka ndodhur në vitin 2019, kur janë regjistruar 508 biznese më shumë se 2018.

Figura 5. Numri i bizneseve të reja aktive në pronësi të pakicave të regjistruara nga viti 2000 deri në mars 2023

Burimi: ARBK



3. Jetëgjatësia e bizneseve në pronësi të grave

Nga viti 2000 deri në mars të vitit 2023 janë çregjistruar 33,003 biznese. Prej tyre, 21,035 (64%) janë në pronësi të burrave; 4,072 (12%) janë në pronësi të grave; 97 (0.3%) janë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje; kurse për 7,799 (23.7%) prej tyre nuk dihet gjinia e pronarëve/eve.

Figura 6. Bizneset e çregjistruara, sipas gjinisë së pronarëve

Burimi: ARBK




Figura 7 tregon bizneset sipas vitit të çregjistrimit. Sipas këtyre të dhënave, ka pasur një numër të madh të bizneseve të çregjistruara në vitin 2016 dhe 2019. Numri i bizneseve të çregjistruara në pronësi të grave ka arritur ngritjen më të madhe në vitin 2022 me më shumë se 100 biznese të çregjistruara krahasuar me vitin 2021. Për 2,564 hyrje nuk ka ndonjë informacion në lidhje me datën e çregjistrimit.

Figura 7. Bizneset e çregjistruara në pronësi të grave, sipas vitit të çregjistrimit

Burimi: ARBK




Tabela 11 tregon bizneset në pronësi të grave të çregjistruara sipas sektorëve të ekonomisë. Analiza e tregon se një pjesë e madhe e bizneseve të çregjistruara ushtronin aktivitet në tregtinë me shumicë dhe pakicë, si dhe aktivitete të tjera shërbimi. Për 1,169 nga bizneset e çregjistruara në pronësi të grave, nuk ka ndarje sipas sektorit të ekonomisë.

Tabela 11. Bizneset në pronësi të grave të çregjistruara, sipas sektorëve të ekonomisë

Burimi: ARBK

Sektori i ekonomisë	Bizneset e çregjistruara në pronësi të grave	
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	126	3.1%
B - Minierat dhe guroret	0	0.0%
C - Prodhimtaria	237	5.8%
D - Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	0	0.0%
E - Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit	4	0.1%
F - Ndërtimi	32	0.8%
G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave	1,056	25.9%
H - Transporti dhe magazinimi	35	0.9%
I - Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	166	4.1%
J - Informacioni dhe komunikimi	55	1.4%
K - Aktivitete financiare dhe sigurimet	28	0.7%
L - Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	6	0.1%
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	172	4.2%
N - Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	72	1.8%
O - Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimet shoqërore të detyrueshme	4	0.1%
P - Arsimi	93	2.3%
P - Shëndeti i njeriut dhe aktivitetet e punës sociale	121	3.0%
R - Arte, argëtim dhe rekreacion	39	1.0%
S - Aktivitete të tjera shërbimi	655	16.1%
Të tjera	1,169	28.7%
Gjithsej	4,070	

Mbi të gjitha dallimi në përqindje në mes të bizneseve të çregjistruara në pronësi të grave dhe burrave është më i vogël krahasuar me përqindjet e bizneseve aktive në pronësi të grave dhe burrave. Edhe pse të dhënat mbi jetëgjatësinë e bizneseve (data e regjistrimit dhe data e çregjistrimit) nuk janë të plota, një analizë e 3,801 bizneseve të çregjistruara në pronësi të grave tregon që jetëgjatësia mesatare e bizneseve në pronësi të grave është 4.36 vite. Kjo është përafërsisht gjysma e mesatares së jetëgjatësisë prej 8.6 vitesh e bizneseve në pronësi të burrave²⁴. Sektorët me jetëgjatësinë mesatare më të ulët në pronësi të grave janë në administratë publike dhe mbrojtje, sigurim shëndetësor të detyrueshëm (2 vite); bujqësi, pylltari dhe peshkim (2.32 vite); dhe aktivitete të pasurive të paluajtshme (2.33 vite). Bizneset në pronësi të grave me jetëgjatësinë më të madhe operonin në sektorët e shitjes me shumicë dhe pakicë (6.71 vite), transportim dhe magazinim (6.53 vite). Bizneset në pronësi të burrave me jetëgjatësinë më të shkurtër operonin në sektorin e minierës dhe gurorës (11.52 vite), ndërsa ata me jetëgjatësinë më të madhe operonin në sektorin e energjisë, gazit, avullit dhe kondicionerë (5.33 vite).

Figura 8. Jetëgjatësia mesatare e bizneseve në vite, sipas sektorëve të ekonomisë



4. Përfundimi dhe Rekomandimet

Ky raport identifikon profilet e bizneseve në pronësi të grave dhe në pronësi të pakicave. Tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitete shërbimesh dhe prodhimtaria mbeten kryesisht biznese në pronësi të grave. Ndërsa sektorët që kanë pjesën më të vogël të bizneseve në pronësi të grave janë miniera dhe gurorë; aktivitetet e familjeve si punëdhënës; prodhimi i mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara; aktivitetet e organizatave dhe organeve ekstraterritoriale, furnizimi me ujë, kanalizimet, aktivitetet e menaxhimit dhe korrigjimit të mbetjeve, si dhe transporti dhe magazinimi. Komunat me boshllëkun më të madh gjinor sa i përket bizneseve në pronësi të burrave dhe grave janë Dragashi dhe Rahoveci ndërsa komuna me ndarjen gjinore më të barabartën është ajo e Parteshit. Shumica dërmuese e bizneseve në pronësi të grave janë biznese mikro me deri në nëntë të punësuar. Bizneset në pronësi të pakicave janë të fokusuara kryesisht në tregtinë me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, prodhimi dhe bujqësia, pylltaria dhe peshkimi. Këto biznese janë kryesisht të vendosura në Prishtinë, Prizren dhe Graçanicë.

Së fundmi, analiza e evidenton një jetëgjatësi mesatare prej 4.36 vitesh për bizneset në pronësi të grave, krahasuar me mesataren 8.1 vjet për bizneset në pronësi të burrave. Bizneset me jetëgjatësinë më të shkurtër, në pronësi të grave, operonin në këta sektorë: administratë publike dhe mbrojtje, sigurim shëndetsor i detyrueshëm; bujqësi, pylltari dhe peshkim; dhe aktivitete të pasurive të paluajtshme. Bizneset në pronësi të grave me jetëgjatësinë më të madhe operonin në këta sektorë: tregti me shumicë dhe pakicë dhe transportim dhe magazinim.

Raporti mund të përdoret nga autoritetet vendimmarrëse, donatorët, shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara në profilet e bizneseve në pronësi të grave dhe atyre pakicave, në mënyrë që të hartohen siç duhet programet e trajnimit dhe mentorimit, si dhe të rritet pjesëmarrja e tyre në mundësitë e prokurimit. Prandaj, GAP-i rekomandon:

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë një definicion koheziv të asaj se çfarë konsideron "biznes aktiv" dhe të ofrojë mekanizma mbi mbledhjen e të dhënave të besueshme me qëllim që të mos ketë shpërputhje të dhënash, si në rastin kur shifrat e ofruara nga ARBK, ATK dhe ASK nuk përputheshin me njëra-tjetrën. Ndaj këshilloet që MINT-i të udhëheq bashkëpunimin në mes të tri institucioneve që të përafrojnë definicionet aq sa mundesohet.
- Qeveria e Kosovës së bashku me Agjencinë për Barazi Gjinore duhet të monitorojnë në mënyrë aktive institucionet që mbledhin dhe mbajnë të dhëna mbi ndarjen gjinore; të vendosin sanksione më të forta mbi ato që nuk respektojnë Ligjin mbi Barazinë Gjinore.
- Qeveria së bashku me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Ministrinë e Administrimit Lokal duhet të propozojnë dhe zbatojnë politika gjithëpërfshirëse për të promovuar ndërmarrësinë e grave dhe të minoriteteve në komuna, me focus më të madh në ato komuna ku bizneset në pronësi të grave dhe minoriteteve janë të nënpërfaqësuar (sidomos në: Dragash, Rahovec, Shtime, Malishevë dhe të tjera).
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe angjencitë e saja duhet të organizojnë diskutime/konsultime mbi hulumtimin për palët e interesuara përfshirë dhe donatorët, Administratën e Tatimit në Kosovë, Agjencinë për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, Agjencinë e Statistikave të Kosovës, shoqatat e bizneseve, dhomat e tregtisë, organizatat e shoqërisë civile, mbi përpilimin e duhur të informacionit lidhur me bizneset në pronësi të grave dhe minoriteteve.

Anekset

Aneksi 1. Llojet e bizneseve

Biznes individual	Pronari i Biznesit Individual ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet dhe obligimet tjera me Ligj or kontratë ndaj Biznesit Individual. Emri zyrtar i Biznesit Individual duhet të jetë emri dhe mbiemri legjitim të pronarit dhe fjalët "Biznes Individual" ose akronimin "B.I".
Ortakëria e përgjithshme	Te ortakëria e përgjithshme, të gjithë ortakët kanë përgjegjësi të pakufizuar dhe janë solidarë për borxhet e organizatës. Organizata kolektive ka një emër që mund të përfshijë emrin e njërit prej partnerëve, duke vendosur menjëherë pas tij akronimin "O.P."
Ortakëria e kufizuar	Te ortakëria e kufizuar, ortakët "e kufizuar" janë përgjegjës për obligimet e kompanisë në raport me vlerën e kontributeve të tyre në kapital themeltar. Ortakëria ka emër, i cili mund të përfshijë emrin e një ose më shumë ortakëve, duke i vënë pas akronimin "O.K".
Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar janë ato organizata, kapitali i të cilave ndahet në aksione dhe aksionarët janë përgjegjës vetëm për nivelin e vlerës së kontributit të tyre. Organizata mund të themelohet dhe të ketë një ose më shumë aksionarë. Ka një emër pas së cilit duhet vendosur menjëherë akronimin "SH.P.K". Vlera e kapitalit themeltar për këto organizata duhet të jetë të paktën 10,000 euro.
Shoqëria e Huaj Tregtare	Kompania e huaj është shoqëri tregtare dhe prej momentit të regjistrimit konsiderohet si dega në Kosovë që nuk ka identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm. Emri Zyrtar i Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Kosovë duhet të përfshijë emrin e plotë të Shoqërisë së Huaj Tregtare me prapashtesën "Dega në Kosovë" ose shkurtesën "D.K".
Ndërmarrjet shoqërore	Ndërmarrje shoqërore do të thotë një person juridik që shumica e asetëve dhe kapitali janë në pronësi shoqërore . Këto ndërmarrje deri në privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit sipas Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
Ndërmarrjet publike	Ndërmarrja Publike është ndërmarrje e cila kryen veprimtarinë e interesit të përgjithshëm, që është e themeluar nga shteti. Ndërmarrja publike monitorohet nga Qeveria dhe organizohen si Shoqëri Aksionare në përputhje me ligjin në fuqi mbi shoqëritë tregtare. Të gjitha interesat pronësore në një ndërmarrje publike do të përfaqësohen me aksione dhe të gjitha këto aksione duhet të jenë të regjistruara.
Kooperativat bujqësore	Kooperativa bujqësore është një shoqëri tregtare e krijuar nga persona fizikë ose juridikë të cilët duhet të jenë të gjithë fermerë që kontribuojnë me pronën e tyre private në kapitalin e përbashkët. Kooperativa bujqësore themelohet nga së paku pesë (5) fermerë nënshkrues të obligimeve. Kooperativa nuk do të krijohet pa kapital dhe nuk do të ekzistojë pa kapital. Kapitali është i ndarë në aksione me vlerë të barabartë me vlerë minimale 10 Euro. Drejtori nuk mund të jetë anëtar i kooperativës. Të gjitha këto mund të shihen në Ligjin Nr. 2003/9 për Kooperativat Bujqësore dhe Ligjin Nr.03/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kooperativat Bujqësore Nr-2003/9.

Burimi: Ligji Nr. 06/L-016 shoqëritë tregtare, <https://bit.ly/3BVY4kr>.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në vitin 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+383 38 609 339

info@institutigap.org

